

Vendim nr. 159, datë 20.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (H) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **HYKMET (HYQMET) GURRA**, përfaqësuar nga avokati Petrit Pepa.

IDRIZ GURRA, përfaqësuar nga kujdestari ligjor.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3923, datë 06.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Idriz Gurra është përfshirë në një aksident automobilistik, të ndodhur në datën 16.10.2010 në aksin rrugor Kavajë-Durrës, si pasojë e të cilit kanë ndërruar jetë shtetasit B.G. dhe R.G., si dhe janë dëmtuar rëndë kërkuesi Idriz Gurra, drejtues i automjetit, dhe shtetasit P.G. (bashkëshortja e të ndjerit B.G.) dhe E.G., në gjini të afërt me njëri-tjetrin. Në kuadër të procedimit penal të regjistruar për këtë ngjarje është kryer akti i ekspertimit autoteknik nr. 1235, datë 10.12.2010, në të cilin është konkluduar se shkak i aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të automjetit, kërkuesit Idriz Gurra.

2. Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë, me vendimin nr. 12-2011-91, datë 03.02.2011, ka deklaruar fajtor kërkuesin Idriz Gurra për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, pika 2, i Kodit Penal (KP) dhe e ka dënuar atë me 3 vjet e 4 muaj burgim. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 333, datë 12.09.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ndryshimin e pezullimit të dënimit me burgim për kërkuesin në zbatim të nenit 59 të KP-së dhe vënien e tij në provë për një periudhë 4-vjecare, me kusht që të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 829, datë 13.06.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorisë kundër vendimit të gjykatës së apelit.

3. Shtetasja P.G. e dëmtuar nga aksidenti së bashku me vajzën e saj M.G., të dyja trashëgimtare ligjore të të ndjerit B.G., që humbi jetën në të njëjtin aksident, i janë drejtuar fillimisht Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) me kërkesë për dëmshpërblim, pasi mjeti shkaktar i aksidentit i drejtuar nga i afërmi i tyre nuk ka qenë i siguruar për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Për shkak se BSHS-ja nuk ka proceduar me trajtimin përkatës të kërkesës për dëmshpërblim, të dëmtuarat i janë drejtuar gjykatës me kërkesë për shpërblimin e dëmit pasuror, jopasuror dhe shpenzimet e tjera për shkak të aksidentit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 715, datë 11.10.2014), me vendimin nr. 2796, datë 20.05.2016, ka vendosur: i) pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe detyrimin e BSHS-së të shpërblejë paditësen P.G. për dëmin e saj shëndetësor, atë për shkak të humbjes së jetës së bashkëshortit, si dhe shpenzimet për perkujdesje, farmaceutike e të varrimit; detyrimin e BSHS-së të paguajë në favor të paditëses M.G. shpërblimin për dëmin që lidhet me dëmtimin shëndetësor të nënës dhe humbjen e jetës së babait; ii) rrëzimin e kërkesëpadisë kundër shoqërisë së sigurimit; iii) pushimin

e gjykimit të padisë së ndërhyrësve kryesorë, kërkuesit Hykmet Gurra dhe shtetasës L.G. Lidhur me këta të fundit, ajo gjykatë ka evidentuar se në seancën e datës 18.03.2016 ndërhyrësit kryesorë kanë depozituar deklaratën noteriale të datës 27.02.2016, me të cilën heqin dorë nga kërkimi i dëmshpërblimit për humbjen e jetës së djalit të tyre B.G., deklaratë të cilën e kanë përsëritur edhe në seancën e diskutimeve përfundimtare (datë 20.05.2016). Për rrjedhojë ajo gjykatë ka çmuar se ishin kushtet për të pushuar gjykimin për ta (*shih faqen 12 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*).

5. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur ankim BSHS-ja dhe ndërhyrësit kryesor, kërkuesi Hykmet Gurra dhe shtetasja L.G. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 739/10-2017-1807, datë 11.07.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me pretendimet e ndërhyrësve kryesorë, gjykata e apelit ka evidentuar se ato nuk kundërshtojnë vendimmarrjen jopërfundimtare për pushimin e gjykimit të çështjes për ta, por se nëpërmjet tyre pretendohet rrëzimi i padisë së paditëseve. Në kushtet që ndërhyrësit kryesorë nuk ishin palë në atë çështje dhe nuk kanë provuar asnjë interes vetjak, të sigurt dhe të drejtpërdrejtë të cenuar në lidhje me padinë, gjykata e apelit i ka gjetur pretendimet e tyre haptazi të pabazuara (*shih faqen 15 të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës*).

6. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs BSHS-ja, ndërsa ndërhyrësit kryesorë kanë paraqitur parashtrime me anë të të cilave kanë pretenduar paligjshmërinë e vendimeve të gjykatave në lidhje me dëmshpërblimet që u janë akorduar paditëseve, me pretendimin se vendimi bie në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, se ai është mbështetur në akte ekspertimit të pabazuara dhe se shumata e dëmshpërblimeve që u janë akorduar atyre janë tej çdo logjike. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3923, datë 06.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga BSHS-ja për shkak të heqjes dorë nga rekursi.

7. Pas ekzekutimit të titullit ekzekutiv, BSHS-ja i është drejtuar gjykatës për të kërkuar nga shkakrtari i aksidentit, i pasiguruar, kërkuesi Idriz Gurra, kthimin e vlerës së dëmit që u ka paguar të dëmtuarave nga aksidenti automobilistik. Kërkuesi Hykmet Gurra ka depozituar në datën 17.10.2025, në sekretarinë e gjykatës, një kërkesë për pezullimin e këtij gjykimi, me qëllim caktimin e një kujdestari ligjor për të birin e tij, i paditur. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 7215, datë 21.11.2025, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së BSHS-së dhe detyrimin e kërkuesit Idriz Gurra për t'i kthyer asaj vlerën e dëmit të paguar në favor të të dëmtuarave. Ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykimi është zhvilluar në mungesë

të të paditurit, i cili, megjithëse është njoftuar rregullisht, nuk është paraqitur në asnjë seancë përgatitore dhe gjyqësore.

8. Në datën 09.02.2026 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit, është regjistruar në datën 24.02.2026.

II

Pretendimet e kërkesve

9. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e mëposhtme:

9.1. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, për shkak të pranimit të kërkesës për heqjen dorë nga Gjykata e Lartë të rekursit të BSHS-së në dhomën e këshillimit, pa thirrur palët (ndërhyrësin kryesor Hykmet Gurra), duke lejuar një marrëveshje korruptive mes BSHS-së dhe paditëseve. Kjo situatë ka lënë pa mbrojtje kërkesin Idriz Gurra, i cili nuk ka ushtruar rekurs më vete, duke besuar në rekursin e paraqitur nga BSHS-ja.

9.2. *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak të tërheqjes së papritur të rekursit nga BSHS-ja, pasi ka paguar fshehurazi vlerën abuzive, që përbën një mashtrim procedural. Tërheqja e rekursit është bërë vetëm për të legjitimuar padinë e regresit ndaj kërkesit Idriz Gurra, i cili, për më tepër, është person me aftësi të kufizuara.

9.3. *Standardi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të caktuar*, pasi procesi në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 10 vjet dhe ka përfunduar me një heqje dorë nga rekursi të stimuluar. Ky fakt është tregues se gjykata nuk ka përmbushur detyrën për të dhënë drejtësi brenda një afati të arsyeshem, por ka shërbyer si mjet për skemën e zhvatjes se parave.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose

juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës, sipas neneve 31 e 31/a të këtij ligji.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi Idriz Gurra nuk ka qenë palë në procesin civil të kundërshtuar, të lidhur me shpërblimin e dëmit që palët e dëmtuara nga aksidenti kanë kërkuar gjyqësish nga BSHS-ja, ndaj ai nuk legjitimohet *ratione personae* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Për më tepër, ky kërkuës pretendohet se është me aftësi të kufizuara (për shkak të aksidentit) dhe se përfaqësohet nga kujdestari i tij ligjor, kërkuesi Hykmet Gurra. Ky fakt pretendohet se vërtetohet, sipas tyre, nga një kopje e vërtetimit nr. 300, datë 08.04.2025 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (KMCAP), bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, në të cilën vërtetohet se kërkuesi Idriz Gurra plotëson kushtet për të fituar të ardhura invaliditeti nga data 01.05.2025 deri më 30.04.2026, pasi vuan nga çrregullime depressive. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se nuk është paraqitur ndonjë vendim gjyqësor (ose kërkesë drejtuar gjykatës) me anë të cilit t’i jetë hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar kërkuesit Idriz Gurra dhe të jetë caktuar si kujdestar ligjor i ati Hykmet Gurra, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Për sa i takon kërkuesit Hykmet Gurra, ai ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, ndaj, nga pikëpamja procedurale, e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar.

13. Për sa i përket aspektit material të legjitimitimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe

se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi Hykmet Gurra ka hequr dorë nga gjykimi i padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan gjatë rigjyimit dhe ajo gjykatë, në përputhje me parashikimet e nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pushimin e gjykimit për ndërhyrësit kryesorë (*shih paragrafin 4 të vendimit*). Ndërsa Gjykata e Apelit Durrës i ka gjetur haptazi të pabazuara pretendimet e tij, në kushtet që nuk kundërshtonte vendimmarrjen jopërfundimtare për pushimin e gjykimit të çështjes, por pretendonte rrëzimin e padisë së paditëseve (*shih paragrafin 5 të vendimit*). Në këto rrethana, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuesit Hykmet Gurra janë ngritur për të mbrojtur të drejtat kushtetuese të personave të tjerë dhe se ai nuk ka paraqitur ndonjë argument se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese nga procesi gjyqësor i kundërshtuar.

15. Për sa më lart, Kolegji çmon se në rastin konkret kërkuesi Idriz Gurra nuk justifikon nga aspekti procedural interesin për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, ndërsa kërkuesi Hykmet Gurra nuk justifikon nga pikëpamja substanciale interesin vetjak, të drejtpërdrejtë dhe real, ndaj ata nuk legjitimohen *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.